



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 13354 Prot.

Fier më 21.11.2025

PROJEKT-VENDIM
Nr. 103 datë 21.11/2025

“Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij, për vitin 2026”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt. __. __.2025, i paraqitet për shqyrtim, materiali nga Komisioni i Strehimit, Bashkia Fier për miratimin e vlerave maksimale të subvencionit të qirasë dhe miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij, për vitin 2026.

Në zbatim të Ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023 datë 22.06.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, nenet 33, 34, 38/1 pika 1.2, të aktit normativ VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr. 301 “Mbi normat e strehimit” dhe detyrimeve ligjore të përcaktuara në të për procedurat ligjore që duhet të plotësojë familja aplikante, për të përfituar strehim, VKM nr.469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, Udhëzimit nr.3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive”, Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika1, 2, neni 9 pika1.1/b, si dhe nenit 54, gërma “k”

Propozon:

1.Miratimin e vlerave mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij, për strukturat e banimit në territorin e Bashkisë Fier, në zonat rurale dhe ato urbane, si më poshtë:

Struktura e apartamentit/banesës

Vlera mesatare e qirasë në tregun e lirë

1.Garsonierë	13.000 Lekë
2. Apartament 1+1	18.000 Lekë
3.Apartament 2+1	22.000 Lekë
4. Apartament 3+1	25.000 Lekë

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e bazvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.

3. Vendimi Këshillit Bashkiak nr.136, datë 21.12.2024, “Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, për vitin 2025, shfuqizohet.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Shërbimit me Një Ndalesë, Drejtoria e Politikave dhe Shërbimeve Sociale si dhe Komisioni i Strehimit, Bashkia Fier;

Komisioni i Strehimit

Pranvera Çina

Denisa Azizaj

Melsi Bogdani

Themion Mile

Endri Jaupaj

Kreshnik Dapi

Rrapi Gjika

Elvi Daka

Natasha Sollaku

**KRYETAR
ARMANDO SUBASHI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARE E BASHKISË

MIRELA PITUSHI

